# KANGAROO

## MANUAL PËR APLIKACIONIN WEB

Për nxënësin

# Identifikimi

# VIZITONI

https://exam.kangaroo.al

JU LUTEMI TA VIZITONI ADRESËN NGA NJË SHFLETUES INTERNETI **GOOGLE CHROME** OSE **FIREFOX** PËR SIGURI DHE PERFORMANCË MË TË MIRË.

Mos e vizitoni adresën nëpërmjet rrjeteve sociale pasi aplikacioni do të hapet me një shfletues interneti i cili nuk është i përshtatshëm për këtë aplikacion web. Për rrjedhojë nuk mund t'ju garantojë siguri në zhvillimin dhe ruajtjen e saktë të testit.




Vendosni username-in tuaj në formatin *emer.atesi.mbiemer*

Nëse keni harruar fjalëkalimin, ndiqni udhëzimet për të krijuar një të ri

Nëse nuk jeni të regjistruar në sistem Krijoni një llogari të re!

# Regjistrimi

# VIZITONI

## https://exam.kangaroo.al

Nëse nuk keni krijuar ende një llogari në sistem, plotësoni formën e regjistrimit me të dhënat tuaja **të sakta**.

- Vendosni një **adresë emaili** reale, përndryshe ju nuk do t'ju vijë email konfirmimi dhe për rrjedhojë nuk do mundeni të aktivizoni llogarinë tuaj.
- Nëse shkolla juaj nuk gjendet në listën që shfaqet, dërgoni email në adresën frederik.dara@gmail.com me emrin e shkollës suaj që doni të shtohet dhe provoni pas disa orësh përsëri.




Pasi të shtypni **Regjistrohu**, në adresën e email që keni vendosur do t'ju vijë një email për aktivizimin e llogarisë.




Nëse jeni i regjistruar në sistem, kaloni te ndërfaqja e identifikimit

# Regjistrimi

Në emailin e dërguar shtypni **Aktivizo** për të aktivizuar llogarinë tuaj



**Verifikoni llogarinë tuaj**

Klikoni butonin më poshtë për të verifikuar llogarinë tuaj.

Username-i juaj është **emer.atesi.mbiemer**

Aktivizo

Ky email u dërgua pasi ju kërkuat një llogari të re në aplikacionin KANGAROO

Butoni i aktivizimit përdoret nga përdoruesi vetëm 1 herë. Nëse ju e klikuat butonin aktivizo dhe llogaria u aktivizua, ky buton e humbet me pas vlefshmërinë, do të merrni mesazhin që linku ka skaduar. Kjo nënkupton që aktivizimi është kryer një herë dhe ju mund të lohoheni pa problem në sistem.

Ju do të ridrejtoheni në këtë faqe në të cilën konfirmohet që llogaria juaj u krijua. Kjo nënkupton që ju tashmë mund të logoheni pa proplem në llogarinë që sapo krijuat.



**Llogaria u konfirmua**

Tashmë ju mund të identifikoheni në aplikacionin KANGAROO.

Username-i juaj është **emer.atesi.mbiemer**

Nëse dëshironi të logoheni klikoni këtu



# Regjistrimi në testim







Zgjidhni klasën ku jeni aktualisht për tu regjistruar në testimin e duhur. Konfrimoni regjistrimin tuaj në testim.

Me konfirmimin e ketij hapi ju ende nuk e keni përfunduar procesin e regjistrimit në testim. Ju do të quheni zyrtarisht i regjistruar vetëm në momentin që pagesa juaj konfirmohet nga përgjegjësi/administratori

# Regjistrimi në testim




Ju keni ende mundësi të modifkoni testin ku jeni regjistruar në rast gabimi për aq kohë sa pagesa juaj nuk është konfirmuar ende

Nëse e keni kryer pagesën në bankë, procedoni me ngarkimin e faturës për të finalizuar regjistrimin tuaj në testim

# Pagesa




Klikoni mbi butonin e pagesës për të ngarkuar faturën e marrë në bankë

Nëse e keni kryer pagesën në bankë, procedoni me ngarkimin e faturës për të finalizuar regjistrimin tuaj në testim




Pasi të klikoni dorëzo faturen, ajo do të shkojë për konfirmim te përgjegjësi/administratori. Ju do të quheni zyrtarisht të regjistruar në testim në momentin që përgjegjësi/administratori do të aprovojë faturën tuaj. Ju do të njoftoheni me email në momentin që konfirmohet.

# Faqja kryesore

Pasi pagesa juaj të jetë konfirmuar ju do t'ju shfaqet pamja si më poshtë. Kjo pamje nënkupton që ju tashmë jeni zyrtarisht të regjistruar dhe mbetet thjesht të prisni datën dhe orën e provimit për të filluar



# Menu




Tek menuja majtas do të keni mundësi të:

- NDRYSHONI FJALËKALIMIN
- PËRDITËSONI PROFILIN
- DILNI nga aplikacioni web

# Nisja e testit

Ju mund të identifikoheni edhe përpara se të nisë testi. Në atë rast do t'ju shfaqet dritarja më poshtë.




Data dhe ora e testit

Ju mund të rifreskoni faqen në çdo moment. Kur ora e testit të ketë filluar, do të shfaqet butoni si më poshtë.



# Nisja e testit

Për të nisur testin, klikoni në butonin me emrin e testit.



# Testi

Pasi të keni shtypur butonin, do t'ju shfaqet testi si në figurën më poshtë, me të gjitha pyetjet që ai ka.




Ju duhet të lexoni me kujdes pyetjen, dhe më pas të zgjidhni alternativën që mendoni se është e saktë.

PËRGJIGJET TUAJA SI DHE PËRDITËSIMET E TYRE RUHEN NË MËNYRË AUTOMATIKE.

# Opsione

Këtu do të gjeni orën e fillimit dhe të mbarimit të testit




Në të djathtë ndodhet gjithashtu menuja për të dalë nga faqja ose për të ndryshuar fjalëkalimin.



# Dorëzimi i testit

Nëse keni pyetje tek të cilat nuk jeni përgjigjur, atëherë do t'ju rikujtohet. Ju gjithsesi mund ta dorëzoni testin!



# Dorëzimi i testit

Kur të keni arritur fundin e testit dhe dëshironi ta dorëzoni **para** se të mbarojë koha, ju duhet të shtypni butonin **DORËZO**




Kur të klikoni **DORËZO** do t'ju shfaqet një dritare konfirmuese. Nëse jeni të sigurtë klikoni PO, nëse jo klikoni JO dhe mund të vazhdoni me testin nëse koha nuk ka përfunduar.




BUTONI DORËZO ËSHTË VETËM PËR TË DORËZUAR TESTIN NË RAST SE MBARONI **PARA** SE TË PËRFUNDOJË KOHA. NËSE KOHA MBARON,TESTI DORËZOHET **AUTOMATIKISHT**!

# Përfundimi i testit

- Koha FILLON dhe MBARON në intervalin e përcaktuar të testit i cili ju është komunikuar nga organizatorët e KANGAROO.
- Klikoni MBYLL për tu ridrejtuar në faqen kryesore, ku do t'ju shfaqen në kohë reale pikët që keni grumbullar.

## E RËNDËSISHME

Në momentin që koha mbaron, do t'ju shfaqet një dialog i cili ju njofton se koha ka mbaruar (si në figurë). Pas këtij momenti ju nuk mund të bëni më asgjë.




MBYLL

# Rezultati




Pikët tuaja

Në momentin që ju dorëzoni testin ose koha mbaron, do të ridrejtoheni në faqen kryesore, ku do të shikoni dhe pikët e grumbulluara.

Ju urojmë suksese!

Për çdo pyetje, paqartësi, jeni të lutur të na kontaktoni në:

info@kangaroo.al